



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË

## KËSHILLI I BASHKISË

### VENDIM

Nr. 94 datë 25-09-2025

#### PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 158 DATË 26.11.2024 PËR “NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2025”

Këshilli i Bashkisë Korçë, në mbledhjen e tij të datës së sotme pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve të anëtareve.

## KËSHILLI I BASHKISË

### VENDOSI

1. Të miratojë, ndryshimin në vendimin nr. 158 datë 26.11.2024 për “NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2025” si më poshtë:

**Në Kapitullin VI, Tarifa të Institucioneve të Varësisë, 6.1 Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Korçë.**

#### Të shtohet:

Përfshihen nga pagesa e tarifës për vizitë në kullën panoramike kategoria e personave me aftësi të kufizuara.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 27 vota

Vota Pro 27

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 25-09-2025

